

**PROCESVERBAL**  
**nga seanca e 42-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime**  
**Mediatike Audio dhe Audiovizuele**  
**mbajtur më 18.11.2022**

**Anëtarë të pranishëm të Këshillit të Agjencisë:** Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të AVMU-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të AVMU-së, mr.Alma Mashoviq, dr.Metodija Jançeski, Lazar Trajçev, Zoran Fidanoski.

**Anëtarë në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /**

**Në seancë ishte i pranishëm dr.Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.**

**Të pranishëm nga Shërbimi Profesional:** mr.Dragica Ljubevska, Goran Radunoviq, mr.Magdalena Davidovska Dovleva, mr.Emilija Petreska Kamenjarova, Maja Damevska, dr.Ivana Stojanovska.

**Të pranishëm të tjerë:** Viktor Atovski, kameraman nga TV Kanal 5.

Z. Petrushevski e hapi seancën e 42-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele. Seanca filloi në ora 14:00 dhe u mbajt në ambjentin e Agjencisë, salla e konferencave në katin e dytë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi:

**RENDIN E DITËS**

1. Miratim i Propozim-procesverbalit nga seanca e 41-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, e mbajtur më 3.11.2022.
2. Projekt-plan vjetor për kryerje të mbikëqyrjes programore për 2023.
3. Projekt-plan vjetor për kryerje të mbikëqyrjes administrative për 2023.
4. Plan-program për punën e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për 2023 (me Plan-program të aktiviteteve të planifikuara dhe Projekt-plani financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për 2023).
5. Propozim për marrje të vendimit për Ribalans të planit financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për 2022.
6. Propozim-informacion drejtuar organit kompetent për të drejtat autoriale dhe të drejtat gjinore, me dyshimin se është kryer shkelje e tyre.
7. Propozim për iniciimin e procedurës për kundërvajtje kundër operatorit Makedonski Telekom nga Shkupi për shkelje të nenit 141 nga LSHMAAV.
8. Propozim për shqiptim të masës vërejtje publike ndaj SHTR ZDRAVKIN Angelçe Zdravkin SHPKNJP Veles për shkelje të nenit 50 paragrafi (3) nga LSHMAAV dhe nenit 19 të Rregullores për mbrojtjen e të miturve.
9. Propozim për shqiptim të masës vërejtje publike ndaj SHTR TV ZDRAVKIN Angelçe Zdravkin SHPKNJP, Veles për shkelje të nenit 53 paragrafi (2) nga LSHMAAV.

10. Propozim për shqiptim të masës vërejtje publike ndaj SHTR TV ZDRAVKIN Angelëe Zdravkin SHPKNJP, Veles për shkelje të nenit 64 paragrafi (1) nga LSHMAAV.
11. Propozim për shqiptim të masës vërejtje publike ndaj SHTR TV ZDRAVKIN Angelëe Zdravkin SHPKNJP, Veles për shkelje të nenit 92 paragrafët (1) dhe (3) nga LSHMAAV.
12. Propozim për dhënien miratim për zbatim të procedurës për furnizim publik-shërbime: Kontroll teknik i ashensorëve dhe platformës.
13. Propozim për dhënien miratim për zbatim të procedurës për furnizim publik-shërbim: Shërbime shtypi.
14. Të ndryshme.

### **Pika 1**

Këshilli i Agjencisë pasi shqyrtoi dhe njëzëri miratoi Procesverbalin e seancës së 41-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 3.11.2022, me tekstin e propozuar.

### **Pika 2, 3 dhe 4**

Z. Petrushevski propozoi pikat 2, 3 dhe 4 të shpjegohen me një hyrje të përbashkët, gjithashtu që të diskutohet për tri pikat dhe pastaj votimi të jetë individual për të gjitha pikat.

Anëtarët e Këshillit nuk kishin asnjë kundërshtim për këtë propozim.

Z. Trajçevski shpjegoi Projekt-planin vjetor për mbikëqyrje të programeve për 2023, Projekt-planin vjetor për mbikëqyrje administrative për vitin 2023 dhe Projekt-programin për punën e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për 2023 (me Projekt-programin e aktiviteteve të planifikuara dhe Projekt-planin financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për 2023). Ai shpjegoi se Plani Vjetor për mbikëqyrje programore përfshin mbikëqyrjet e rregullta programore për vitin 2023 që do t'i kryejë Agjencia në tri grupet e subjekteve: transmetuesit, ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuele sipas kërkesës dhe mbi operatorët e rrjeteve publike të komunikimit elektronik. Në Plan janë përcaktuar qartë se cilat obligime nga Ligji do t'i nënshtrohen mbikëqyrjes dhe në cilën periudhë të vitit do të kryhet mbikëqyrja. E gjithë kjo do të publikohet në ueb faqen e Agjencisë dhe të gjitha subjektet dhe palët e interesuara do të kenë një pasqyrë, kur Agjencia do të kryejë mbikëqyrjen për grupin përkatës të subjekteve. Në lidhje me Planin Vjetor për mbikëqyrjen administrative ai shpjegoi se ka të bëjë me mbikëqyrjet e rregullta që do të bëhen mbi transmetuesit dhe botuesve të medias së shkruar, si dhe përcaktoi saktësisht periudhën kur do të kryhet mbikëqyrja dhe për cilat detyrime. Programi i punës së Agjencisë përbëhet nga programi i aktiviteteve të planifikuara dhe plani financiar. Në programin e aktiviteteve të planifikuara janë paraparë qëllimet që do të arrihen në vitin 2023, të gjitha aktivitetet që do të ndërmerren për arritjen e synimeve, rezultatet e pritura dhe periudha e realizimit. Në fillim ai veçoi dy aktivitete më të rëndësishme: së pari, lejet e pjesës së shumicës së transmetuesve ekzistues pushojnë së vlefshmi në fillim të vitit 2024, dhe për këtë arsye në gjysmën e dytë të vitit Agjencia do të duhet të zbatoj procesin për vazhdimin e vlefshmërisë së lejeve, sigurisht të atyre transmetuesve që do të paraqesin kërkesë në pajtim me Ligjin. Një tjetër aktivitet shumë i rëndësishëm që Agjencia duhet të zbatojë në vitin 2023 është zhvillimi i strategjisë

rregullatore për periudhën e vitit 2024-2028. Si edhe më parë, ky proces do të jetë plotësisht gjithëpërfshirës, domethënë në zhvillimin e strategjisë do të përfshihen të gjitha subjektet përkatëse. Arsimimi mediatik dhe sigurimi i aksesit në programe për personat me aftësi të kufizuara shqisore do të jenë në fokusin e Agjencisë edhe gjatë vitit 2023. Edhe këtë vit do të organizohen Ditët e arsimimit mediatik, dhe do të vazhdojë përkrahja e rrjetit maqedonas për arsimim mediatik.. Do të ndërmerren aktivitete për të inkurajuar ofruesit e shërbimeve të mediave audiovizuele për të siguruar akses në programet/ përmbajtjet e tyre për personat me aftësi të kufizuara shqisore dhe do të thellohet bashkëpunimi me organizatat e personave me aftësi të kufizuara shqisore. Në drejtim të nxitjes së lirisë së shprehjes dhe lirisë së medias janë planifikuar aktivitete për forcimin e kulturës editoriale dhe për pavarësinë e politikës editoriale të transmetuesve, si dhe për rritjen e ndërgjegjësimit për rëndësinë e standarteve profesionale gazetareske. Programi përfshin të gjitha aktivitetet që Agjencia do të ndërmarrë për të garantuar respektim më të madh të obligimeve për transmetuesit e programeve, detyrimet për të siguruar publicitet në punën e tyre, si dhe mbrojtjen e pluralizmit të pronësisë së transmetuesve. Programi përcakton gjithashtu aktivitetet që synojnë të sigurojnë respektim më të madh të detyrimeve të përcaktuara në Ligj për ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuele sipas kërkesës, operatorëve të rrjeteve publike të komunikimit elektronik dhe botuesve të medias së shtypit (shkruar). Në vitin 2023, bashkëpunim ndërkombëtar Agjencia do të arrijë përmes pjesëmarrjes në takimet e organizatave dhe shoqatave ndërkombëtare nga sfera audiovizuele në të cilën është anëtare ose ka status vëzhgues, dhe në kuadër të procesit të integritimit evropian, Agjencia do të marrë pjesë në procesin e hartimit të ndryshimeve të legjislacionit mediatik për shkak të pajtueshmërisë së tij me Direktivën për Shërbimet Mediatike Audiovizuele. Në lidhje me Projekt- planin finasiar për vitin 2023 , ai sqaroi se të ardhurat dhe shpenzimet e përgjithshme janë planifikuar të arrijnë në 147.724.505,00 denarë. Nga ana e të ardhurave, të (hyrat) ardhurat më të mëdha janë planifikuar të realizohen nga Buxheti i RMV-së në vlerë prej 54 milionë denarë (sipas mjeteve të planifikuara për këtë qëllim në Propozim-Buxhetin e RMV për vitin 2023). Në fakt parashikohen të njëjtat fonde si vitet e kaluara, pavarësisht se Buxheti shënon rritje të ndjeshme çdo vit. Pastaj nga mjetet e transferuara nga vitet e kaluara në vlerë prej 52.724.505,00 denarë, nga lejet 26 milionë denarë dhe 11 milionë denarë nga mbikëqyrja për ritransmetim të shërbimeve programore përmes rrjeteve publike të komunikimit elektronik. Të ardhurat e planifikuara nga lejet janë ulur për 25%, sipas Konkluzionit të miratuar nga Këshilli për donacionin e synuar për të gjithë transmetuesit komercial dhe jofitimprurës në vlerë prej 25% të tarifës vjetore për leje. Nga ana e shpenzimeve në Projekt- planin e propozuar, shpenzimet më të mëdha janë paraparë në pozitën e pagave të llogaritura në shumë prej 57.355.505,00 denarë. Për blerje të pajisjeve janë paraparë mjete në vlerë prej 16.246.000,00 denarë, që janë të planifikuara për pagesë të blerjes fillestare të Sistemit automatik të menazhimit të dokumentave, për projektim, furnizim, instalime, performacë dhe kyçje në rrjetin energjistik të impiantit fotovoltik të instaluar në selinë e Agjencisë dhe për prokurimin e TIK (pajisjeve të informacionit) për virtualizim. Të ardhurat më të larta për shpenzime të energjisë së konsumuar në vitin 2023 për shkak të krizës energjitike pritet të arrijnë në 16.650.000,00 denarë. Të ardhura më të larta kemi dhe në Projektligjin për vitin 2023 janë pozita e shërbimeve intelektuale në vlerë prej 13.736.000,00 denarë dhe mërëmbajtja investive e aksesit në vlerë prej 12.758.000,00 denarë. Të gjitha këto janë në shumën e vlerës së shumë të parashikuara si në vitet e kaluara. Projekt-plani finasiar i propozuar për vitin 2023 është më i vogël se plani finasiar i miratuar për vitin 2022 i cili arrinte 148.504.238,00 denarë. Në fund ai deklaroi se nëse nevojitet sqarim i detajuar i Projekt-planit finasiar dhe Projekt-planit

të punës, në seancë janë të pranishëm dhe udhëheqësit e sektorëve për t'iu përgjigjur pyetjeve.

Z.Fidasoski tha se e ka shqyrtuar Projekt-verzionin e Programit të punës dhe do të diskutojë për të. Në lidhje me Projekt-planin vjetor për mbikëqyrjen e programit për vitin 2023 dhe Projekt-planin për mbikëqyrjen administrative për vitin 2023, ai tha se janë të standartizuara dhe se do të ofrojë mbështetje për të tri pikat, sepse beson se janë punuar në mënyrë solide dhe profesionale nga ana e shërbimit dhe shpreson që ashtu si në vitet e kaluara dhe në vitin 2023 ato do të zbatohen plotësisht. Në të janë parashikuar të gjitha ato aktivitete që janë të nevojshme për funksionimin e organit rregullator. Ai veçoi mbikëqyrjen si aktivitet thelbësor, por siç përmendi drejtori Trajçevski duke përfshirë dhe arsimimi mediatik, lirinë e shprehjes, bashkëpunimin ndërkombëtar, analizën, hulumtimet. Drejtori Trajçevski iu referua disa pikave nga draft versioni i Programit të punës, për të cilat do të japë edhe mendimin e tij. Para së gjithash, është strategjia e re rregullatore për periudhën 2024-2028. Strategjia aktuale, e cila është ende aktuale, për herë të parë fillimisht është bërë si një strategji rregullatore për industrinë audiovizuale dhe është bërë ashtu siç duhet në çdo aspekt dhe nuk ka dyshim që edhe në të ardhmen do të bëhet me të njëjtën cilësi. Shpreson që ndoshta do të ketë një diskutim paraprak më të gjerë publik që do të përfshijë të gjitha segmentet ose të gjitha sfidat që do t'i ketë aktiviteti audiovizual në vendin tonë dhe më gjerë. Viti i ardhshëm do të jetë një lloj përgatitjeje kushtimisht e thënë për vazhdimin ose mosvazhdimin e lejeve ekzistuese të transmetuesve që skadojnë në fillim të vitit 2024. Ai pret që dhe për këtë temë të ketë një debat publik të frytshëm, të ketë përplasje pikëpamjesh për konceptin aktual me kaq shumë transmetues, me më pak transmetues ose me më shumë transmetues, do të shihet se çfarë do të mbizotërojë në opinionin publik.. Para së gjithash, ai mendon për ata transmetues që kanë leje ekzistuese tokësore dhe pret që ajo të kristalizohet para vazhdimin të lejeve, kush do dhe që nuk do ta mbajë lejen, do të jenë dëshmitar të vazhdimin ose ndoshta dhënies së lejeve të reja. Ai sugjeroi në dy aspekte që janë të përfshira në program. Viti i ardhshëm do të jetë përgatitor në drejtim të implementimit të direktivës së rishikuar audiovizuale, e cila ndryshon në thelb disa relacione të veprimtarisë audiovizuale, dhe që i nënshtrohen ndryshimeve më të thella ligjore që duhet të ndodhin, dhe sipas tij do të kërkohet miratimi i një Ligji krejtësisht të ri, sepse siç thonë juristët nëse ka nevojë të ndryshohet më shumë se një e treta e ligjit ekzistues, mendimi i tij modest është se duhet miratuar një Ligj i ri, sepse jo vetëm Direktiva por edhe aspekte të tjera do të duhet të përfshihen siç janë përqëndrimi mediatik dhe të ngjajshme. Prandaj, sipas tij, do të ishte më mirë të silllet një Ligj i ri si zgjidhje që do të ofrohet dhe miratohet nga ligjvënësi. Ai beson se vitin e ardhshëm do të ketë një diskutim të gjerë publik ku do të kemi përplasje konceptesh, mendimesh, argumente në tryezë, se nuk do të ketë propozime për ligje që duhet të miratohen brenda natës, siç po ndodh tani me projekt versionin aktual që do të sjellë Kuvendi, se në fund do të jetë si një propozim, pavarësisht nëse do të jetë i ngjajshëm për një lëmi të caktuar apo për më shumë lëmi, por mbi të gjitha të jetë rezultat i një debati të gjerë publikë që do të ofrohet, e cila do të sjellë argumente, fakte, koncepte, kundërshtime apo miratime që do të japin zgjidhje më të mira të mundshme. Ai e mbështeti programin, beson se është i përshtatur profesionalisht, beson se do të miratohet nga Këshilli pa asnjë problem. Ai ka dhënë mbështetje edhe për planin e propozuar financiar, por edhe pse është më i vogël se ai aktual, beson se mjetet do të jenë të mjaftueshme sepse siç tha ai Agjencia si organ menazhon në mënyrë të rregullt.

Z.Petrushevski tha se të tria dokumentet janë të përgatitur në mënyrë të detajuar, dhe cilësinë e vlerëson të shkëlqyeshme, që është standarte për Agjencinë dhe do të ofrojë

mbështetje për të tre Projektet. Ai iu referua strategjisë rregullatore për periudhën 2024-2028. Ai deklaroi se kohë më parë ka filluar përgatitjen për ndryshimin e LSHMAAV në drejtim të respektimit të direktivave të fundit evropiane. Ai nuk e di nëse është e mundur, vetëm mendim se këto dy aktivitete mund të ndikojnë njëra në tjetrën. Në fakt, ato ndryshime që do të përcaktohen në ndryshimet e ligjit duke respektuar Direktivën evropiane duhet të bëhen pjesë përbërëse e strategjisë së re dhe anasjelltas. Siç tha z. Trajçevski, është shumë e rëndësishme që të përfshihen sa më shumë faktorë relevant në zhvillimin e strategjis rregullatore për periudhën 2024- 2028 që të jetë sa më gjithëpërfshirëse. Është veçanërisht e rëndësishme që ministria kompetente të përfshihet sa më shumë, sepse në fund janë ata që atë që shkruhet në Strategji ta propozojnë në Kuvend si Ligj. Ajo që nuk shkruhet në materiale është nëse në hartimin e Strategjisë Agjencia do të mbështetet ekskluzivisht tek subjektet vendase, ekspertët, televizionet, ministria, apo do të ketë ndoshta ndihmën e ekspertit evropian si dhjetë vite më parë. Ai sugjeroi që shërbimi të mendojë për këto punë dhe shpreson që do të zhvillohet një strategji që do të jetë shumë e mirë dhe do të ketë ndikim për 5 vitet e ardhshme siç është shkruar. Ai deklaroi se do të mbështesë të tre Projekt dokumentet në formën e propozuar.

### Votimi për Pikën 2

Këshilli i Agjencisë miratoi njëzëri Projekt-planin vjetor për kryerjen e mbikëqyrjes programore në vitin 2023, me tekstin e propozuar.

Agjencia në lidhje me Projekt-planin vjetor për kryerjen e mbikëqyrjes programore në vitin 2023, të veprojë në pajtim me nenin 10 të Ligji për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale dhe nenit 47 të Rregullores për punën e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Tekst i pastruar) nr. 01-3732/1 datë 29.7.2019.

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Projekt-planin vjetor të lartpërmendur duhet ta publikojë në ueb-faqen e Agjencisë, në afat prej 30 ditësh, në mënyrë që të sigurohet debat publik dhe t'u mundësohet të gjitha palëve të interesuara të shprehin mendimet, pikëpamjet dhe qëndrimet e tyre.

### Votimi për Pikën 3

Këshilli i Agjencisë miratoi njëzëri Projekt-planin vjetor për kryerjen e mbikëqyrjes administrative në vitin 2023, me tekstin e propozuar.

Agjencia, në lidhje me Projekt-planin vjetor për kryerjen e mbikëqyrjes administrative në vitin 2023, të veprojë në pajtim me nenin 10 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale dhe nenit 47 të Rregullores për punën e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Tekst i pastruar) nr.01-3732/1 datë 29.7.2019.

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Projekt- planin vjetor të lartpërmendur duhet ta publikojë në ueb-faqen e Agjencisë, në afat prej 30 ditësh, në mënyrë që të sigurohet debat publik dhe t'u mundësohet të gjitha palëve të interesuara të shprehin mendimet, pikëpamjet dhe qëndrimet e tyre.

### Votimi për Pikën 4

Këshilli i Agjencisë miratoi njëzëri Projekt-programin e punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2023 (me Projekt-programin e aktiviteteve të planifikuara dhe Projekt-planin financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike audio dhe Audiovizuale për vitin 2023), me tekstin e propozuar.

Agjencia në lidhje me Projekt-programin e punës së lartpërmendur, duhet të veprojë në pajtim me nenin 10 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale dhe nenit 47 të Rregullores për punën e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Tekst i pastruar) nr. 01-3732/1 datë 29.7.2019.

Sektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Projekt-programin e punës së lartpërmendur ta publikojë në ueb-faqen e Agjencisë, në afat prej 30 ditësh, në mënyrë që të sigurohet debat publik dhe t'u mundësohet të gjitha palëve të interesuara të shprehin mendimet, pikëpamjet dhe qëndrimet e tyre.

## **Pika 5**

Z. Trajçevski shpjegoi Propozimin për miratimin e vendimit për Ribalancin e planit financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike audio dhe Audiovizuale për vitin 2022. Shpjegoi se me këtë ribalanc shpenzimet totale do të mbeten të njëjta. Nga artikujt (shkallët) përkatës të shënuara në material do të sigurohen 500.000,00 denarë, të destinuara për energji termike në vlerë prej 250.000,00 denarë dhe rritje të mjeteve të destinuara për kompensim për shpenzimet për fjetje gjatë udhëtimeve zyrtare jashtë vendit në vlerë prej 250.000,00 denarë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Vendim me të cilin miraton ribalancin e Planit financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2022, nr.05-3587/1 datë 29.9.2022.

Me ribalancin e propozuar të Planit Financiar për vitin 2022, shpenzimet totale të planifikuara mbeten në nivelin e përcaktuar më parë, pra arrijnë në 148.504.238,00 denarë.

Me propozimin e ribalancit sigurohen mjete financiare në vlerë të përgjithëshme prej 500.000,00 denarë, të destinuara për energji termike në vlerë prej 250.000,00 denarë dhe rritje të mjeteve të destinuara për kompensim të shpenzimeve për fjetje gjatë udhëtimeve zyrtare jashtë vendit në vlerë prej 250.000,00 denarë.

Sektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, vendimin e lartpërmendur ta publikojë në ueb faqen e Agjencisë.

## **Pika 6**

Z. Trajçevski sqaroi Propozim-informacionin drejtuar organit përgjegjës për të drejtat autoriale dhe të drejtat e përafërta, për shkak të dyshimit se është bërë shkelja e tyre. Sqaroi se nga ana e SHTR Kanal 5 Shkup është parashtruar kërkesë në Agjenci që në afat sa më të shkurtër të parashtrohet kallëzim penal në prokurorinë publike kompetente kundër personit juridik operatorit TOTAL TV për shkak të ekzistimit të dyshimit për shkelje të së drejtës autoriale dhe të drejtave të përafërta nga operatori TOTAL TV sepse në pretendimet nga ana e transmetuesit të TV Kanal 5 thuhet se ai ritransmeton përmbajtjet e tij programore në disa vende të botës pa e rregulluar paraprakisht të drejtat autoriale dhe të drejtat e përafërta. Në pajtim me LSHMAAV Këshilli i Agjencisë në këto raste është i obliguar që informacioni për dyshimin e shkeljes t'ia dorëzojë organit kompetent që ndjek penalisht mosrespektimin e Ligjit

për të drejtën autoriale, që është Ministria e Punëve të Brendshme-Qendra për shkatërrimin e krimit të organizuar dhe serioz, dhe kjo praktikë ka ekzistua gjithmonë.

Këshilli i Agjencisë, në bazë të Kërkesës së pranuar për iniciimin e kallëzimit penal para organeve kompetente nga ana e SHTR KANAL 5 SHPKNJP Shkup nr.03-4221/1 datë 11.11.2022 me të cilën kërkohet që në afat kohor sa më të shkurtër të parashtrohet kallëzim penal në prokurorinë publike kompetente kundër personit juridik të Shoqrisë për Tregti dhe Shërbim TOTAL TV SHPK Shkup, njëzëri vendosi që Ministrisë së Punëve të Brendshme – Qendra për Asgjësimin e krimit të organizuar dhe të rëndë t'i dorëzojë informatat për ekzistimin e dyshimit për shkelje të së drejtës autoriale dhe të drejtave të përafërta nga ana e operatorit të rrjetit publik të komunikimit elektronik, Shoqëria për Tregti dhe Shërbime TOTAL TV SHPK Shkup, me tekstin e propozuar.

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, informacionin e mësipërm duhet ta publikojë në ueb faqen e Agjencisë.

## **Pika 7**

Z. Trajçevski shpjegoi Propozimin për iniciimin e procedurës për kundërvajtje kundër operatorit Makedonski Telekom nga Shkup për shkelje të nenit 141 të LSHMAAV. Ai shpjegoi se nga mbikëqyrja u konstatua se ky operator ritransmeton dy shërbime programore që nuk mbulohen me vërtetimin (çertifikatë) për regjistrimin e dhënë nga Agjencia. Duke pasur parasysh faktin se kemi të bëjmë me shkelje për të dytën herë gjatë këtij viti, paraprakisht i është shqiptuar njëherë masë vërejtje publike, në pajtim me Ligjin propozohet që ndaj këtij operatori të ngrihet procedura për kundërvajtje.

Z. Petrushevski i bëri një pyetje drejtorit. Me sa kujtohet nga vitet e kaluara, ai konsideron se kjo është shkelja e parë që Makedonski Telekom e ka bërë dhe pyeti nëse ka të drejtë?

Z. Trajçevski u përgjigj se ndoshta kështu ka qenë këto vitet e fundit, por para kësaj ka pasur edhe procedura të tjera për kundërvajtje ndaj Makedonski Telekom.

Z. Petrushevski tha se është i habitur nga pasaktësia e tillë në funksionimin e këtij operatori.

Këshilli i Agjencisë pasi shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të rregullt programore me nr.11-4061/1 datë 2.11.2022 të Makedonski Telekom Shoqëri Aksionare për Komunikim Elektronik-Shkup, dhe konstatoi shkelje të nenit 141 të LSHMAAV.

Këshilli njëzëri konkludoi kundër Shoqërisë Aksionar për Komunikim elektronik Makedonski Telekom-Shkup të iniciojë procedurë për kundërvajtje para gjykatës kompetente sepse mbikëqyrja ka konstatuar se operatori në fjalë, i cili sipas njoftimit të Agjencisë për komunikim elektronik mund të kryej veprimtari në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, më datë 1.11.2022 për përdoruesit (shfrytëzuesit) e tij ka ritransmetuar shërbimet programore „Nova S“ dhe „Brainz“ i cili nuk mbulohet me çertifikatë për regjistrim të shërbimit programor e dhënë nga Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, e cila është në kundërshtim me nenin 141 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Spektori për çështje juridike dhe furnizim publik të përgatisë Kërkesën për fillimin e procedurës për kundërvajtje para gjykatës kompetente për operatorin në fjalë.

## **Pikat 8, 9, 10 dhe 11**

Z. Petrushevski tha se Pikat 8, 9, 10 dhe 11 i referohet të njëjtit medium por për shkelje të ndryshme të LSHMAAV. Në këtë drejtim, ai propozoi që të bëhet një hyrje dhe diskutim i përbashkët dhe më pas votimi të bëhet për çdo shkelje në veçanti.

Ndihmës udhëheqësja e Sektorit për çështje programore mr.Emilija Petreska Kamenjarova, ka shpjeguar propozimet për shqiptimin e masës vërejtje publike për shkelje të nenit 50 paragrafi (3), nenit 53 paragrafi (2), nenit 64 paragrafi (1) dhe nenit 92 paragrafët (1) dhe (3) të LSHMAAV nga ana e SHTR TV ZDRAVKIN Angelçe Zdravkin SHPKNJP, Veles. Ajo shpjegoi se këto shkelje janë konstatuar me mbikëqyrje të rregullt. Shkelja e parë u konstatua në emisionin e shfaqur humoristike „Ajde da zazhmurimo“ pasi është transmetuar pa sinjale paralajmëruese përkatëse para fillimit dhe pa shenjë klasifikimi për kategorinë e programit gjatë gjithë kohëzgjatjes, çka paraqet shkelje të nenit 50 paragrafi (3) të LSHMAAV. Shkelja e radhës ka të bëjë me transmetimin e komunikimeve komerciale të fshehta audiovizuale të paligjshme, të konstatuara në kuadër të emisionit argëtues-dokumentar „Mastraf muabet“, janë transmetuar dhe pesë video promocionale për: „Hotel Drim“, „Oskarplast“, „Misa - megamarket“, „Nabiz“, „Elit kafe“ dhe „Vakçare“, të cilat paraqesin komunikime të fshehta komerciale audiovizuale, përkatësisht shkelje të nenit 53 paragrafi (2) të LSHMAAV. Shkelja e tretë i referohet nenit 64 paragrafi (1) të LSHMAAV sepse më 10 tetor 2022, deklarata e analistit nga Bullgaria, Vladimir Vladimirov, në emisionin „Stadium“, u transmetua fillimisht në gjuhën bullgare, pa u siguruar përkthimi në gjuhën maqedonase. Gjithashtu, deklarata e Severinës midis disa këngëve të saj gjatë Koncertit në Zagreb u transmetua fillimisht në kroatisht, pa u siguruar përkthim në gjuhën maqedonase. Shkelja e fundit e TV Zdravkin është për nenin 92 paragrafët (1) dhe (3) të LSHMAAV sepse më 10 tetor 2022, nuk ka transmetuar së paku 30% të programeve të krijuara burimore si vepra audiovizuale maqedonase dhe as të paktën gjysmën e minimumit ligjor të programit të krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase, që i transmetonte në periudhën nga ora 7,00 deri në ora 19,00. Për të gjitha shkeljet, propozohet shqiptim i masës paralajmërim publik me afat për harmonizimin e veprimtarisë në pajtim me Udhëzuesin për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës, e më pas të kryhet mbikëqyrje kontrolli.

Z. Fidanoski tha se ka një vërejtje teknike në pikën 9, ku sipas tij është bërë gabim i paqëllimshëm. Emri i mysafir të intervistuar hendbollistit „Nikolçe Mojsoski“ në fakt është „Naumçe Mojsoski“. Në këtë drejtim, ai propozoi që të kontrollohet edhe një herë dhe nëse po, atëherë të korrigohet Raporti.

Z. Ajdini tha se ishte pak i befasuar nga numri i shumtë i shkeljeve nga ana e këtij televizioni, i cili ka një përvojë pune prej 30 vitesh, ndaj pyeti nëse shërbimi ka ndonjë informacion për arsyet e këtij mosrespektimi të Ligjit? Ai ka deklaruar se pavarësisht përgjigjes do të votojë për shqiptim të masës paralajmërim publik për të 4 pikat.

Ndihmës udhëheqësja e Sektorit për çështje programore mr.Emilija Petrevska Kamenjarova, ka shpjeguar se nuk e di arsyen sepse pas Raporteve të dorëzuara nga mbikëqyrja, transmetuesi nuk është deklaruar në lidhje me shkeljet dhe për këtë arsye as nuk janë dorëzuar në material si zakonisht kur ka deklarata.

Z. Trajçevski në lidhje me mediat lokale dhe rajonale, sqaroi se çdo vit monitorohen transmetues të ndryshëm dhe i vjen të monitorohen çdo 3 deri në 4 vjet. Kjo është praktika kur gjithmonë kryhen mbikëqyrje për të mbuluar disa nene të Ligjit dhe në këtë rast



konstatohen një numër i madh i shkeljeve, siç ishte rasti para një ose dy vitesh me TV Nova nga Gjevgjelia, këtë vit me TV Gurra nga Kërçova e kështu me radhë. Këto gabime ndoshta ndodhin sepse nuk mbikëqyren për një periudhë të gjatë kohore, disavjeçare dhe transmetuesit relaksohen dhe harrojnë detyrimet e tyre Ligjore.

Z. Petrushevski tha se ndoshta kjo është arsyeja, janë të relaksuar sepse nuk janë në fokus, shikueshmëria është relativisht e vogël, bëhet fjalë për mjedis lokal.

Z. Fidanoski si plotësim të diskutimit, tha se sipas asaj që ka mundur të shqyrtoj në material, ka përshtypjen se disa nga këto përmbajtje të monitourara programore mund të jenë ndërmarrë nga transmetues të tjerë dhe kushtimisht thënë ato janë transmetuar vetëm në eterin e këtij transmetuesi, d.m.th janë ndërmarrë plotësisht pa u shqyrtuar në detaje nëse do të shkelin ndonjë nen të LSHMAAV. Me siguri këtu është bërë mbikëqyrje, por nuk është bërë monitorim, materiali nuk është shqyrtuar nëse ka marketing të fshehtë dhe të ngajshme.

### Votimi për pikën 8

Këshilli i Agjencisë pasi shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të rregullt programore, me nr.10-4075/1 datë 2.11.2022 dhe njëzëri konstatoi se ndaj SHTR TV ZDRAVKIN Angelçe Zdravkin SHPKNJP, Veles t'i shqiptojë masë paralajmërim publik për shkelje të nenit 50 paragrafi (3) të LSHMAAV dhe nenit 19 të Udhëzuesit për mbrojtjen e personave të mitur sepse më 5 tetoe 2022, në emisionin humoristik „Ajde da zazhmurimo“ është transmetuar pa sinjal adekuat paralajmërues para fillimit dhe pa shenjë klasifikimi për kategorinë e programit gjatë gjithë kohëzgjatjes.

Në pajtim me pikën 6 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës me nr.01-6039/1 datë 20.10.2015, ndaj SHTR TV ZDRAVKIN Angelçe Zdravkin SHPKNJP, Veles urdhërohet që në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit për shqiptimin e masës paralajmërim publik të harmonizojë veprimtarinë e tij me LSHMAAV dhe Rregulloren për mbrojtjen e personave të mitur.

Spektori për çështje juridike dhe furnizim publik të përgatisë aktvendimin për shqiptimin e masës paralajmërim publik për transmetuesin në fjalë.

Spektori për çështje programore pas skadimit të afatit të përcaktuar në Aktvendim për paralajmërim publik të kryej mbikëqyrje kontrolli, për të konstatuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht ose nuk ka vepruar).

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit duhet të publikojë aktvendimin e mësipërm në ueb faqen e Agjencisë.

### Votimi për pikën 9

Këshilli i Agjencisë pasi shqyrtoi Raportin me shkrim me nr.10-4074/1 datë 2.11.2022 për mbikëqyrjen e kryer të rregullt programore dhe njëzëri konstatoi se ndaj SHTR TV ZDRAVKIN Angelçe Zdravkin SHPKNJP, Veles t'i shqiptojë masë paralajmërim publik për shkelje të nenit 53 paragrafi (2) të LSHMAAV sepse më 5 tetor 2022, në kuadër të „Mastraf muabet“, emision dokumentar-argëtues, janë transmetuar pesë spote promovuese për: „Hotel

*Drim*, „Oskarplast“, „Misa - megamarket“, „Nabizi“, „Elim kafe“ dhe „Bakçare“, që përfaqësojnë komunikime të fshehta komerciale audiovizuale.

Në pajtim me pikën 4 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës (tekst i pastruar) nr.01-6039/1 datë 20.10.2015, ndaj SHTR TV ZDRAVKIN Angelçe Zdravkin SHPKNJ, Veles urdhërohet menjëherë pas pranimit të aktvendimit të harmonizojë veprimtarinë e tij me dispozitat nga Ligji për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Spektori për çështje juridike dhe furnizim publik të përgatisë aktvendimin për shqiptimin e masës paralajmërim publik për transmetuesin në fjalë.

Spektori për çështje programore pas skadimit të afatit të përcaktuar në Aktvendim për paralajmërim publik të kryejë mbikëqyrje kontrolli, për të konstatuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht ose nuk veproi).

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit duhet ta publikojë aktvendimin e mësipërm në ueb faqen e Agjencisë.

#### Votimi për pikën 10

Këshilli i Agjencisë pasi shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të rregullt programore me nr.10-4066/1 datë 2.11.2022 dhe njëzëri konkludoi se ndaj SHTR TV ZDRAVKIN Angelçe Zdravkin SHPKJNP, Veles t'i shqiptoi masë paralajmërim publik për shkelje të nenit 64 paragrafi (1) të LSHMAAV sepse më 10 tetor 2022, deklarata e analistit nga Bullgaria, Vladimir Vladimirov në emisioni „Stadion“, u transmetua fillimisht në gjuhën bullgare, pa u siguruar përkthim në gjuhën maqedonase. Ghithashtu, deklaratat e Severinës midis disa këngëve të saj gjatë Koncertit në Zagreb u transmetuan fillimisht në kroatisht, pa u siguruar përkthim në gjuhën maqedonase.

Në pajtim me pikën 5 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar) nr.01-6039/1 datë 20.10.2015, urdhërohet që në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit të harmonizojë veprimtarinë e tij me dispozitat e nenit 64 paragrafi (1) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Spektori për çështje juridike dhe furnizim publik të përgatisë aktvendimin për shqiptim të masës paralajmërim publik për transmetuesin në fjalë.

Spektori për çështje programore, pas skadimit të afatit të përcaktuar në Aktvendim për paralajmërim publik, të kryejë mbikëqyrje kontrolli, për të konstatuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht ose nuk veproi).

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, duhet ta publikojë aktvendimin e mësipërm në ueb faqen e Agjencisë.

#### Votimi për pikën 11

Këshilli i Agjencisë pasi shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të rregullt programore, me nr.10-4065/1 datë 2.11.2022 dhe njëzëri konstatoi se ndaj SHTR TV ZDRAVKIN Angelçe Zdravkin SHPKNJ, Veles t'i shqiptoi masë paralajmërim publik për

shkelje të nenit 92 paragrafët (1) dhe (3) të LSHMAAV sepse më 10 tetor 2022, nuk ka transmetuar së paku 30% të programit të krijuar burimor si vepra audiovizuele maqedonase, si edhe as gjysmën e minimumit ligjor të programit të krijuar burimor si vepra audiovizuele maqedonase, që e transmetonte në periudhën nga ora 7,00 deri në ora 19,00.

Në pajtim me pikën 6 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës me nr. 01-6039/1 datë 20.10.2015, urdhërohet që në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit të harmonizojë veprimtarinë e tij me dispozitat e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Sektori për çështje juridike dhe furnizim publik të përgatisë aktvendimin për shqiptim të masës paralajmërim publik transmetuesit në fjalë.

Sektori për çështje programore pas skadimit të afatit të përcaktuar në aktvendim për paralajmërim publik, të kryejë mbikëqyrje kontrolli, për të konstatuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht ose nuk veproi).

Sektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit duhet ta publikojë vendimin e mësipërm në ueb faqen e Agjencisë.

## **Pika 12**

Udhëheqësi i njësisë për furnizime publike mr. Aleksandër Xhuvareviq shpjegoi propozimin për dhënien miratim për zbatimin e procedurës për furnizim publik-shërbim: Revizion (kontroll) teknik i ashensorëve dhe platformës. Ai shpjegoi se bëhet fjalë për furnizim publik dyvjeçar që do të zbatohet si procedurë me vlerë të ulët. Ky furnizim rezulton nga detyrimet ligjore për të cilat Agjencia si subjekt është e detyruar të kryej kontroll teknik të ashensorëve dhe platformave, në radhë të parë për arsye të përdorimit të sigurt. Ky furnizim do të zbatohet së bashku me Agjencinë për Rini dhe Sport.

Këshilli i Agjencisë miratoi njëzëri zbatimin e procedurës për furnizim publik për lëndën (artikullin) e radhës të furnizimit publik-shërbim: Kontroll teknik i ashensorëve dhe platformës.

Zbatimi i procedurës së furnizim publik për lëndën-shërbim: Revizion teknik i ashensorëve dhe platformës është parashikuar dhe është në pajtim me Planin Vjetor për furnizime publike për vitin 2022 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Tekst i pastruar) nr.05-3616/1 datë 30.9.2022, ndërsa mjetet sigurohen nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2022, përkatësisht do të parashikohen shtesë dhe në Planin Financiar të Agjencisë për vitin 2023.

## **Pika 13**

Udhëheqësi i njësisë për furnizime publike mr. Aleksandër Xhuvareviq, ka shpjeguar propozimin për dhënien miratim për zbatimin e procedurës për furnizim publik-shërbim: Shërbime printimi. Ai shpjegoi se ky furnizim është për një vit dhe po ashtu i përket furnizimeve me vlerë të ulët me vlerë të llogaritur prej 600 mijë denarë.

Z. Petrushevski tha se ndoshta bëhet fjalë për shërbime të veçanta printimi si broshura, botime, dhe të ngjajshme, për të cilën ka marrë konfirmim nga ana e shërbimit të njësisë. Ai shpreson se do të paraqiten më shumë ofrues që të mund të fitohet një çmim më i ulët.

Këshilli i Agjencisë miratoi njëzëri zbatimin e procedurës për furnizim publik për lëndën (artikullin) e radhës për furnizim publik-shërbim: Shërbime printimi.

Zbatimi i procedurës për furnizim publik për lëndën-shërbim: Shërbime printimi është parashikuar dhe është në pajtim me Planin Vjetor për furnizime publike për vitin 2022 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Tekst i pastruar) nr.05-3616/1 datë 30.9.2022, ndërsa mjetet janë siguruar nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2022.

#### **Pika 14**

#### **Të ndryshme**

Nuk ka pasur asnjë diskutim nën Të ndryshme.

**Nr. 02-4270/14**

**28.11.2022**

**Shkup**

**Agjencia për Shërbime  
Mediatike Audio dhe Audiovizuele  
Kryetar i Këshillit  
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v**